



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18935 Prot.

Lezhë, më 27 . 12 . 2023

VENDIM

Nr. 76, Datë 27. 12. 2023

PËR

MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 2 pika 36 dhe nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", pika 4/a VKM nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023, si më poshtë vijon:
 - a) Qiraja për strukturën e apartamentit Garsionierë është 8 500 (tetë mijë e pesëqind) lekë.
 - b) Qiraja për strukturën e apartamentit 1+1, është 14 100 (katërmëdhjetë mijë e njëqind) lekë.
 - c) Qiraja për strukturën e apartamentit 2+1, është 18 200 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë.
 - d) Qiraja për strukturën e apartamentit 3+1, është 20 200 (njëzet mijë e dyqind) lekë.
2. Vlera maksimale e subvencionimit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë, sipas vlerave të paraqitura në këtë vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI

Në mungesë dhe me autorizim
ZV/KRYETARI
AGOSTIN MARKU



Prot 18935/
dt 6.1.24.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1061/8 Prot.

Lezhë, më 03 .01 .2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, VKM-në nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.76, datë 27.12.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2023".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

